



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari", pn, vvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel. 028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 15. të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.14/ 2003 dhe nenit 11. par. 1. pika 2. të Ligjit për ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106, nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues, nr. 41-02/05 prej 04.mars/2004, nenit 38.pika1.2, 1.3. dhe 1.4. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në mbështetje të dispozitave të Vendimit të KK-ës Gjilan, nr. 01-11741 të dt. 16.10/2008, për miratimin e prioriteteve për hartimin-revidimin e Planeve Rregulluese Urbane, të Qytetit të Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më:17.07.2013, miraton këtë:

V E N D I M I
Për miratimin e Planit Rregullues Urban: " Livadhet e Arapit"

I.

Me këtë Vendim, miratohet Plani Rregullues Urban: "Livadhet e Arapit", i Qytetit të Gjilanit, (në tekstin e mëtejshëm: PRRU:" Livadhet e Arapi", i cili përfshinë hapësirën në mes rrugës Rajonale:Gjilan – Malishev duke filluar nga Qendra e Qytetit, te sheshi "R. Mala-N Berisha", duke vazhduar rrjedhës se poshtme t lumit mirusha deri te kthesa e par e lumit ku kthetet ne drejtim të tregut te gjelbert duke e përcjell kufirin deri te rr. Gjilan –Malishevë (te kthesa) të cilën e përcjell deri në Kuvce të Posshme, kthehet në të djathtë e përcjell rrugën Kufcë –Zabeli deri të varrezat e lagjes, kthehet në të djathtë rrugës në drejtim të livadheve deri rrëzë kodrës, ku kthehet në të majtë e përcjell rrjetin e kanalizimit deri te rr. Zabel-Gjilan, kthehet djathtas duke përcjellë rrugën "Mulla Idrizi" deri në qendër në pikën fillestare, në sipërfaqe prej rreth: 101 hektar.

II.

PRRU: "Livadhet e Arapit", është hartuar nga studioja Projektuse: "Urban +" nga Prishtina.

III.

Dokumenti nga pika paraprake e këtij Vendimi, vërtetohet me Vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit në pesë ekzemplar të shkruar dhe 5 kopje digjitale dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

IV.

Plani nga pika I. e këtij Vendimi përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit, organizimin dhe destinimin e hapësirës së këtij lokacioni, përcakton rregullat dhe kriteret e ndërtimit te objekteve banimore-afariste dhe rrjetit të objekteve publike dhe objekteve të Infrastrukturës teknike komunale.

V.

PRRU: "Livadhet e Arapit", duhet të inkorporohet në Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

VI.

Parcelat e përfshira me këtë plan e të cilat janë të destinuara për objekte publike dhe objekte të infrastrukturës komunale, e që nuk janë pronë Komunale, shpallen me Interes të Përgjithshëm Publik, në tërësi sipas ligjit në fuqi.

VII.

Për zbatimin e këtij vendimi, do të përkujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit përmes, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtorisë për Shërbime Publike të KK-ës Gjilan.

VIII.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ëeb faqen e Komunës.

A r s y e t i m

i Propozim Vendimit për miratimin e Planit Rregullues: "Livadhet e Arapit", në Gjilan

Bazë juridike për miratimin e Vendimit të Planit Rregullues Urban: "Livadhet e Arapit", është Statuti i Komunës së Gjilanit, Vendimi i KK-ës Gjilan për miratimin e Planit Zhvillimor Urban, nr. 01.11735, dt. 30.10 2008, Vendimi i KK-ës Gjilan, për qasjen e revidimit të Planeve Rregulluese Urbane të Qytetit të Gjilanit, Vendimit për miratimin e prioriteteve për hartimin-revidimin e PRrU-ve, nr. 01.11741, dt. 30.10/2008, Ligji për Planifikimin e Hapsinor, nr. 14/2003, Ligji për Ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106 dhe dispozitat që burojnë nga ato ligje.

PRrU: " Livadhet e Arapi", përveq një pjesë shumë të vogël (nga qendra deri te ish shoqata automoto "Drita" ë ka pas Plan detaj urbanistik të viteve 63 dhe shtratit të lumit "Mirusha" sipas projektit të viteve të pasluftës) pjesa tjetër nuk ka qenë e përfshirë me ndonji Plan Detaj Urbansitik dhe shtrihet në pjesën lindore të Qytetit të Gjilanit dhe me interefime të drejtëpërdrejta edhe në pjesët-zonat tjera. në veri me qendrën e qytetit, në lindje me trëgun egjelbërt dhe kampin Montith, në jug m dhe juglindje me shatin Malishev dhe një pjesë të Lagjes së Zabeli dhe në perëndim më Fabrikën e Radiatorëve, Fabrikën e Miellit, rr. regjionale Gjilan- Preshevë etj. dhe është një hapësirë kopakte.

Kjo hapësirë në një sipërfaqe rreth 101 hektar, me një konfiguracion të rrafshët, është pjesërisht e ndërtuar nga pjesa e Qytetit dhe një pjesë të nën unazën e Jugorë dhe përgjatrrugës Gjilan – M e dominuar kryesisht me bnim individual dhe afarizëm në kuadër të banimit pa rrugë të mirëfillta komunikuese brendapërbrenda pjesëve të ndërtuara, me përjatshtim të rrugës Gjilan-Malishevë dhe unazës jugore, e cila deri diku është e ngarkuar për komunikim dhe frekuentim të lirë dhe të papenguar, pa objekte të karakterit të përgjithshëm public, rrjete jo funksionale të Infrastrukturës teknike komunale të cilat janë në process të realizimit (regullimi I shtratit të Lumit "Mirusha" dhe Lumit "Stanishor" i cili pritet të fillojë së realizuari.

Ky Plan përmban normativa teknike, standarde si dhe zgjidhje urbanistike dhe rregullative specifike të organizimit të shfrytëzimit të hapsirës dhe të ndërtimit të objekteve të banimit dhe afarizmit, objekte të arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit-rekreacionit, gjelbërimit, etj., përmbajtje dhe objekte të infrastruktures teknike komunale: rrugëve primare dhe sekondare, trotoareve, stazave dhe aleve të ndryshme, hapsirave të lira dhe gjelbërimit, rregullimit të rrjeteve të ujësjellësit, dhe rrjetit të kalalizimit atmosferik dhe fekal, i cili është trajtuar në mënyrë specifike për shkak të ekzistimit të dy shtrerëve të lumit., krejt kjo me qëllim të krijimit të kushteve dhe mundësive për një jetë dhe veprim të mirë organizuar dhe mundësisë për zhvillim bashkohor dhe të qëndrueshëm.

Gjat procesit të hartimit të këtij plani, ka patur një mori takimesh dhe debatesh me një pjesëmarrje solide të pronarëve të tokave-objekteve të përfshira me këtë plan, ndërsa shqyrtimi public është mbajtur nga data: **08. Nëntor/2012, deri më datë: 08. Dhjetor/2012**, duke dhënë verejteje, sugjerime dhe propozime konkrete për organizimin e shfrytëzimit racional të hapësirave konkrete, për profilin e rrugëve dhe rrjeteve tjera të infrastrukturës komunale.

Këto vërejtje, sygjerime dhe propozime janë analizuar nga hartuesi i këtij plani në bashkpunim me Dejtorinë e Urbanizmit dhe disa nga to janë inkorporuar deri në masën dhe kufirin që lejojnë standardet urbano-arkitektonike, duke mundësuar e realizimit të këtij Planit, ndërsa disa edhe përkundër insistimit të pronarëve sa i përket ndërtimit të destinimeve nuk janë marrë parasysh (rasti i hapësirës së parkut) etj.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e komunës së Gjilanit

Gjilan, Qershor / 2013.